



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 185

**Tiranë – E premte, 20 tetor 2017**

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 102/2017, datë 13.10.2017	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore.....	9195
Vendim i Kuvendit nr. 103/2017, datë 13.10.2017	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”..	9196
Vendim i Kuvendit nr. 12, datë 17.10.2017	Për shfuqizimin e vendimit nr. 7, datë 20.6.2017, “Për delegimin e kompetencave”.....	9196
Dekret i Presidentit nr. 10633, datë 18.10.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	9196
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 87, datë 12.10.2017	Për delegim kompetence.....	9196
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 1044, datë 18.10.2017	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme.....	9197
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 159, datë 4.10.2017	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.....	9199



**VENDIM**  
**Nr. 102/2017**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË**  
**POSAÇËM PARLAMENTAR PËR**  
**REALIZIMIN E REFORMËS**  
**ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1 dhe 78, pika 1 të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore (në vijim Komisioni).

II. Komisioni ka për detyrë hartimin e ndryshimeve të kuadrit ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE-së/ODIHR-it për tri zgjedhjet e fundit të viteve 2013, 2015 dhe 2017, të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet dhe të propozimeve të partive politike që në zgjedhjet e fundit kanë marrë secila jo më pak se 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvendin.

III. Anëtarësia e Komisionit formohet me pjesëmarrjen e partive që kanë përfaqësim parlamentar, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe pakicës.

IV. Komisioni drejtohet nga dy bashkë-kryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

V. Përbërja e Komisionit është si më poshtë:

1. Bledar Çuçi	bashkëkryetar	(PS)
2. Oerd Bylykbashi	bashkëkryetar	(PD)
3. Vasilika Hysi	anëtare	(PS)
4. Alket Hyseni	anëtar	(PS)
5. Adnor Shameti	anëtar	(PS)
6. Klotilda Bushka	anëtare	(PS)
7. Ermonela Felaj	anëtare	(PS)
8. Blerina Gjylameti	anëtare	(PS)
9. Bashkim Fino	anëtar	(PS)
10. Musa Ulqini	anëtar	(PS)
11. Enkelejd Alibeaj	anëtar	(PD)
12. Gent Strazimiri	anëtar	(PD)
13. Nasip Naço	anëtar	(LSI)
14. Luan Rama	anëtar	(LSI)
15. Nard Ndoka	anëtar	(i pavarur)

16. Vangjel Dule	anëtar	(i pavarur)
17. Dashmir Shehi	anëtar	(i pavarur)
18. Fatmir Mediu	anëtar	(PR).

VI. Pranë Komisionit ngrihet Grupi i Ekspertëve Teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

VII. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ekspertë të OSBE-së/ODIHR-it, Këshilli i Evropës, ekspertë të Komisionit të Venecias, si dhe përfaqësues dhe/ose ekspertë të BE-së dhe SHBA-së, ftohen të ndjekin dhe të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e Komisionit dhe të grupit të ekspertëve teknikë të ngritur pranë tij.

VIII. Çdo parti që përfaqësohet në komision, ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Shumica parlamentare mirëpret propozimet e pakicës parlamentare dhe palët duhet të angazhohen të gjejnë konsensusin në lidhje me to. Për çështje të veçanta, për të cilat palët nuk kanë gjetur konsensus, do të vlerësohet dhe kërkohet asistencë e ekspertizës së OSBE-së/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias.

IX. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimmarrja e Komisionit do të synojë konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë marrë njëkohësisht konsensusin e të dy bashkëkryetarëve.

X. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit, me një vendim të veçantë të Kuvendit.

XI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 13.10.2017



**VENDIM**  
Nr. 103/2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, bëhet ky ndryshim:

I. Deputetja Almira Xhambulla caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në vend të deputetes Elona Hoxha.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 13.10.2017

**VENDIM**  
Nr. 12, datë 17.10.2017

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 7, DATË 20.6.2017, “PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE”**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2014, 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Vendimi nr. 7, datë 20.6.2017, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
**Genci Gjonçaj**

**DEKRET**  
Nr. 10633, datë 18.10.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Atdhe Jetmir Mazari
2. Blerind Feti Morina

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Ilir Meta**

**URDHËR**  
Nr. 87, datë 12.10.2017

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Gentian Këri, për çështjet e mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e



grykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadi, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gryqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e grykimit të kësaj çështjeje, si dhe t'i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga sekretari i përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara grykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga sekretari i përgjithshëm me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

IV. Ngarkohet z. Gentian Këri dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjikhuri**

## URDHËR

Nr. 1044, datë 18.10.2017

### PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË BRENDSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

#### URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme në proceset gryqësore, kur thirret si palë në një grykim, lëshohen për aparatit nga sekretari i përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme, kur thirret si palë në grykim, në proceset gryqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit qendror ose i varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadi.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gryqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

4. Përfaqësimi për çdo proces gryqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës, sipas objektit të kërkesëpadi, nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gryqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të grykimit, si dhe të drejtën për të hartuar, dorëzuar dhe nënshkruar kërkesëpadi.

6. Përfaqësuesit e autorizuar të ndjekin me korrektësi seancat gryqësore, për sa u takon pjesëmarrjes së tyre e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, propësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Brendshme.



7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ky është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, qendrore dhe vendore, të caktojnë një person përgjegjës, si pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

9. Për autorizimet e lëshuara nga sekretari i përgjithshëm, deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 38, datë 28.1.2014, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, të ndryshuar, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

10. Ngarkohen institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, drejtoria që mbulon çështjet juridike për aparatën dhe sekretari i përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv/Protokollit për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të varësisë së Ministrisë së Brendshme.

12. Urdhri nr. 38, datë 28.1.2014, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë e përcaktuar në urdhra të tjerë që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM  
Fatmir Xhafaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

**(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2017

**AUTORIZIM**

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN CIVILE ME PALË:

Paditës: .....

E paditur: .....

Objekti: .....

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile dhe të urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. .... , datë ....., “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme”,

**VENDOSA:**

Autorizimin e z/znj. ...., me detyrë ....., për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Brendshme, në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor/në Gjykatën e Apelit/në Gjykatën e Lartë.

**(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT)**



**VENDIM**  
**Nr. 159, datë 4.10.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR  
PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË TË  
DHËNAVE DHE PROCEDURËN PËR  
AKSESIN E FURNIZUESVE NDAJ TË  
DHËNAVE TË OPERATORIT TË  
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE përcakton formatin e të dhënave dhe

procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave.

- Në bazë të nenit 69 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, operatori i sistemit të shpërndarjes i siguron pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë